



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 112/2019

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR
TË KUVENDIT “PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË
KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË
KUADËR TË USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME
ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 13 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit Hetimor,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 84/2019, zgjatet për një periudhë 2-mujore nga data e përfundimit të afatit të këtij komisioni.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 3.10.2019